

Numri i lëndës: 2023:249317

Datë: 31.01.2024

Numri i dokumentit: 05266162

**P.nr.471/2023**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN-Dega V., Departamenti i përgjithshëm, sipas gjyqtarës Blerina Jakupi Ramadani, me bashkëpunëtoreshen profesionale Fitim Limani, duke vendosur në çështjen penale kundër të pandehurit F.I. nga fshati T. Komuna V., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1, të KPRK-së, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm për dhënien e urdhrin ndëshkimor me numër PP.II.nr.1670/2023, të datës 07.11.2023, pas konstatimit se të dhënat në aktakuzë ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor me datë 31.01.2024, mori këtë:**

### **A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan PP.II.nr.1670/2023, të datës 07.11.2023 dhe kjo gjykatë, jep këtë:

### **U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R**

I pandehuri **F.I.**, nga babai Demush, i lindur me dt.21.05.1991, nga fsh. T. K. V., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, shifra e konsumatorit DGL-9017787 me nr. Personal 1231051933 lëshuar nga MPB-Prishtinë.

### **Ë S H T Ë F A J T O R Ë**

Sepse, me datë 12.08.2023, në kohë të pa përcaktuar, në shtëpinë e tij në fshatin T., Komuna V.së, puntëtorët e KEDS-it kanë konstatuar se i pandehuri, si shfrytëzues i energjisë elektrike, ka siguruar shërbimë për të cileat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit, ashtu që fillimisht njehsori elektrik i është shkyqur nga distanca për shkak të borgjit ndaj KEDS-it, mirpo, i pandehuri, pa leje dhe autorizim, ka bërë lidhjen e drejtpërdrejt në rrjetin elektrik, jashtë njehsorit elektrik me qka është pamundësuar regjistrimi i shpenzimeve të energjisë elektrike, në këtë mënyrë të dëmtuarës KEDS-in Distrikti në Gjilan, i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 85 euro.

-me këtë veprim ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 , të KPRK-së.

Prandaj, në bazë të nenit 4,7,17,38,43 të KPK-së dhe nenit 450,458, 495 par. 1, 498 të KPPRK-së, i shqipton:

## **I SHQIPTON** **Denim me gjobë**

Ashtu që të pandehurit F.I.për veprën penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi i caktohet denim me gjobë në shumë prej 100.00 (njëqind) €, të cilin denim i pandehuri do ta paguaj në afat në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.

Nëse i pandehuri i lartcekur nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, atëherë gjykata do t'ia zëvendëson denimin me gjobë me denim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të barazohet me 20 (njëzet) € të dënimit me gjobë.

E dëmtuara KEDS, Distrikti në Gjilan udhëzohet që kërkesën pasurore juridike t'a realizoj në kontest të rregullt civil.

Obligohet i pandehuri që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20€ (njëzet) euro, në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me 16.11.2023 në Gjykatën Themelore në Gjilan, dega në V. ka paraqitur aktakuzën me numër PP.II.nr.1670/2023 të dt.07.11.2023 ndaj të pandehurit F.I.nga fshati T. Komuna V., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe kërkesën PP.II.nr.1670/2023 të dt. 07.11.2023 për dhënien e urdhrin ndëshkimor me shqiptimin e dënimit me gjobë me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 paragrafi 1 të KPP-së.

Gjykata pas shikimit dhe analizimit të aktakuzës përkatëse dhe shkresave të lëndës së bashku me kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se në këtë çështje penalo juridike janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-së për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe komform nenit 495 paragrafi 1, 2 dhe 3 të KPP-së vendosi që të pranojë kërkesën e lartcekur dhe të pandehurit F.I.t'i shqiptoj denim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë si dhe provat e bashkangjitura në të ofrojnë bazë të mjaftueshme për një gjë të tillë dhe deri tek një konstatim i tillë gjykata erdhi duke u bazuar edhe në shkresat e lëndës siç janë: procesverbali me numër 485935 i datës 14.08.2023, lëshuar nga Njësia e Korigjimeve dhe Rikthimit të Humbjeve e të dëmtuarës, fatura DGLHP 2313600 e dt. 14.08.2023, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes janë prova të besueshme dhe të mjaftueshme mbi bazën e të cilave konstatohet bindshëm se i pandehuri ka kryer vepër penale e cila i vihet në barrë me aktin akuzues, andaj bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se edhe me shqiptimin e këtij dënimi mund të arrihen qëllimet e dënimit nga neni 38 i KPRK-së.

Duke pasur parasysh se në dispozitivin e aktakuzës është cekur vlera e dëmit mirëpo lidhur me llogaritjen e këtij dëmi nuk ka ndonjë ekspertizë të veçantë por e njëjta është bërë në bazë të kalkulimit të përgjithshëm RH, të cilën e bën vet e dëmtuara gjykata konsideron se të njëjtat nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për gjykimin e plotë e as të pjesërishtë të kërkesës pasurore

juridike andaj edhe bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP-ës, të dëmtuarën KEDS për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

Vendimin sa i përket shpenzimeve procedurale, gjykata e mori duke u mbështetur në nenin 450 parag. 1 të KPP-së.

Nga të lartëcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - Dega V.**  
**Departamenti i përgjithshëm**  
**P.nr.471/2023, me datë 31.01.2024**

**Gj y q t a r j a,**  
**Blerina Jakupi Ramadani**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, gjyqtare individuale të kësaj gjykate. Kundërshtimi nuk duhet domosdo të arsyetohet. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhërin ndëshkimor merr formën e prerë dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.

